

**“UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**  
**DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE ME BIOTEKNOLOGJI**  
**PROGRAMI SHKENCA E USHQIMIT**



**PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

**“Ndikimi modaliteteve të ndryshme të plehërimit në parametrat fiziko-  
kimik në kultivarin e grurit Pobeda”**

**Mentori:**

**Prof. Asoc. Dr. Salih Salihu**

**Kandidatja:**

**BSc. Vlera Gashi**

**Prishtinë, 2022**

## ABSTRAKTI

Gruri është një ndër katër bimët bujqësore të kultivuara më të rëndësishme që mbillen në rruzullin tokësor. Kokrrat e grurit përdoren kryesisht si drithëra buke, si ushqim i koncentruar për blegtorinë, si farë dhe për qëllime industriale. Nga gruri përgatitet bukë e cilësisë së lartë, biskota, pasta, niseshte mirëpo ndër sfidat kryesore për të ardhmen janë sigurimi i ushqimit të mjaftueshëm për popullsinë botërore në rritje.

Në ditët e sotme, prodhimi bujqësor mbështetet gjithnjë e më shumë në teknologji, si bujqësia precize, mekanizimi dhe plehërat kimike. Gruri si kulturë e rëndësishme në vendin tonë që të zhvillohet gjatë periudhës së tij të rritjes, i duhen elemente ushqyese si artificiale ashtu edhe natyrale në mënyrë që të ketë veti të plota fiziko-kimike, ashtu që edhe rendimenti i kërkuar të jetë i kënaqshëm për kultivuesin. Për të rritur produktivitetin e të mbjellurave dhe për të ndikuar në rritje të pjellorisë së qëndrueshme të tokës, e rëndësishme është prezenca e ekuilibruar e plehërave organik dhe inorganik. Pjelloria dhe cilësia e tokës mund të shpjegohet me disponueshmërinë e lëndëve ushqyese kryesore, dmth. azot (N), fosfor (P) dhe kalium (K) në të.

Për të vërtetuar se si ndikojnë plehërimet e ndryshme në cilësitë fiziko-kimike të lëndës së parë grurë, është bërë një punë eksperimentale hulumtuese në rajonin e Anamoravës, ku katër parcela ekperimentale janë plehëruar në forma të ndryshme (pa pleh, me pleh artificial Urea 400kg, parcelën e tretë me 200 kg Urea dhe 200 kg NAG, dhe e fundit 200 kg NAG dhe 200 kg NAG). Rezultatet e hulumtimit kanë treguar të dhëna interesante për ndikimin e modaliteteve të ndryshme të plehërimit në parametrat fiziko-kimik të kultivarit të grurit Pobeda. Këto rezultate paraqesin rëndësi të madhe për bujqit për të arritur rendimentin dhe cilësinë e dëshiruar të prodhimeve por edhe për përpunuesit e tij.

***Fjalët kyçe:*** Plehërimi, grurë, rendiment, bujqësi, parametra fiziko-kimik.

## ABSTRACT

Wheat is one of the four most important cultivated crops grown on the globe. Wheat grains are mainly used as bread grain, concentrated feed for livestock, as seed and as well as for industrial purposes. Wheat is used of making high-quality bread, cookies, pastries, and starch, but one of the biggest difficulties facing humanity in the future will be food providing of such growing global population. Precision agriculture, mechanization, and chemical fertilizers are only a few examples of the technology that is used in agricultural production nowadays. As an important crop in our country and as regards of growing, wheat needs both artificial and natural nutrients to develop its maximum physicochemical potential and produce a suitable yield for the grower.

In order to increase the productivity of crops and also to influence the growth of sustainable soil fertility, it's crucial to have a great balance of organic and inorganic fertilizers. Hence, the availability of essential nutrients like nitrogen (N), phosphorus (P), and potassium (K) in soil can explain its quality and its fertility.

This study includes an experimental work in the Anamorava region, where four experimental plots were fertilized in different forms on four distinct experimental plots, in order to demonstrate how inorganic fertilizers affect the physicochemical qualities of wheat raw material (without manure, with artificial fertilizer Urea 400 kg, the third parcel with 200 kg Urea and 200 kg NAG, and the last one with 200 kg NAG and 200 kg NAG).

The results of the research have shown interesting data on the influence of different modes of fertilization on the physiochemical parameters of the Pobeda wheat cultivar. These results represent great importance for farmers to achieve the desired yield and quality of products as well as for its processors.

**Key words:** *Fertilization, wheat, yield, agriculture, physicochemical parameters.*